



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2910/14 prot.

Datë 08.02.2024

**V E N D I M**

**Nr. 158/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Tërnova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 96/2024, datë 26.01.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-75800-07-24-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie Ndarë në 3 Lote”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 20,459,753 lekë (pa TVSh), Loti 2, me objekt “Materiale kancelarie të tjera zyre”, me Nr. REF-75817-07-24-2023, me fond limit 3,716,833 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 09.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 8, Tiranë.

Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, me NIPT: K21605003M, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga Dytësore Km 9, Godinë 3 katëshe, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara. Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

**Subjekte të Interesuara:** “Librari Dyrrahu” SHPK me NIPT L91418502J dhe adresë: Zona Kadastrale nr.8517, e llojit truall, plus ndërtesë 4 kate, me sipërfaqe trualli 1’000 m2 dhe sipërfaqe ndërtese, Durrës.

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 8, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 26.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 96/2024, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-75800-07-24-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie Ndarë Në 3 Lote”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 20,459,753 lekë (pa TVSh), Loti 2, me objekt “Materiale kancelarie të tjera zyre”, me Nr. REF-75817-07-24-2023, me fond limit 3,716,833 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 09.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, dhe të korrigojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 140/1 prot., datë 05.02.2024, protokolluar me tonën nr. 291011 prot., datë 07.02.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin 96/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-75800-07-24-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie Ndarë Në 3 Lote”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 20,459,753 lekë (pa TVSh), Loti 2, me objekt “Materiale kancelarie të tjera zyre”, me Nr. REF-75817-07-24-2023, me fond limit 3,716,833 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 09.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

## **II**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 140/1 prot., datë 05.02.2024, protokolluar me tonën nr. 291011 prot., datë 07.02.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin 96/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-75800-07-24-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie Ndarë Në 3 Lote”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 20,459,753 lekë (pa TVSh), Loti 2, me objekt “Materiale kancelarie të tjera zyre”, me Nr. REF-75817-07-24-2023, me fond limit 3,716,833 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 09.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.96/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke skualifikuar operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, në zbatim të vendimit Nr.96/2024, datë 26.01.2024, të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-75800-07-24-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie Ndarë Në 3 Lote”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 20,459,753 lekë (pa TVSh), Loti 2, me objekt “Materiale kancelarie të tjera zyre”, me Nr. REF-75817-07-24-2023, me fond limit 3,716,833 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 09.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara..
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

